

KOMUNA E ULQINIT



ENTI PËR STATISTIKË

Bazuar në nenin 16 paragrafi 1 pika 2 të Ligjit për Regjistrimin e Popullsisë, familjeve dhe banesave ("Gazeta Zyrtare e Malit të Zi", nr. 140/22), komisioni i regjistrimit në **Komunën e Ulqinit**, shpall

### SHPALLJE PUBLIKE

Për angazhimin me kontratë të pjesëmarrësve për zbatimin e Regjistrimit të popullsisë, familjeve dhe banesave, i cili do të mbahet nga data 30 nëntor deri me datën 15 dhjetor 2023, dhe atë:

#### INSTRUKTOR/E: 12 + 1 rezervë

#### KUSHTET E PËRGJITHSHME:

- Qytetar/e nga mosha madhore e Malit të Zi;
- Shtetësia e Malit të Zi;
- Kualifikimi i nivelit arsimor VI, VII1, VII2 dhe VIII.

#### KUSHTE TË VEÇANTA:

- Të njoh gjuhën që përdoret në zonën që po anketohet

#### PËRPARËSI DO TË KENË KANDIDATËT QË PLOTËSOJNË DISA NGA KUSHTET E MËPOSHTME:

- Vendbanimi në Komunën e Ulqinit, për të cilin aplikon (për shkak të njohjes me terrenin);
- Që personi është i papunë;
- Përvojë në realizimin e hulumtimeve statistikore;
- Përvojë në kryerjen e trajnimeve, organizimin dhe koordinimin e aktiviteteve me një numër të madh njerëzish.

#### DOKUMENTET QË DUHET TË BASHKENGJITHEN ME APLIKIM:

- Aplikim për pjesëmarrësit në regjistrim (Formulari P-13);
- Kopja e kartës së identitetit ose çertifikatës së shtetësisë së vlefshme;
- Një kopje të një diplome ose çertifikate të nivelit dhe llojit të arsimit të përfunduar;
- Vërtetim nga Zyra e Punësimit të Malit të Zi për persona të papunë ose vërtetim se personi është pensionist;
- Dëshmi për përvojën statistikore, si dhe përvojën në mbajtjen e trajnimeve, organizimin dhe koordinimin e aktiviteteve me një numër të madh personash (kontratë pune/çertifikatë/rekomandime).

## **Regjistruer: 110 + 5 rezerva**

### **KUSHTET E PËRGJITHSHME:**

- Qytetar i rritur i Malit të Zi;
- Shtetësia e Malit të Zi;
- Kualifikimi i arsimit të nivelit IV, V, VI, VII1, VII2 dhe VIII dhe (III për pjesëtarët e popullsisë rome dhe egjiptiane).

### **KUSHTE TË VEÇANTA:**

- Të njohin gjuhën e përdorur në zonën që po anketohet.

### **PËRPARËSI DO TË KENË KANDIDATËT QË PLOTËSOJNË DISA NGA KUSHTET E MËPOSHTME:**

- Vendbanimi<sup>1</sup> në Komunën e Ulqinit, për të cilën aplikon (për shkak të njohjes me terrenin);
- Që personi është i papunë;
- Përvojë në realizimin e hulumtimeve statistikore;
- Anëtarët e komunitetit rom dhe egjiptian kanë prioritet për angazhim në vendbanimet rome.

### **DOKUMENTET QË DUHET TË BASHKENGJITHEN:**

- Aplikim për pjesëmarrësit në regjistrim (Formulari P-13);
- Kopja e kartës së identitetit ose çertifikatës së shtetësisë së vlefshme;
- Një kopje të një diplome ose çertifikate të nivelit dhe llojit të arsimit të përfunduar ose dëshmi se personi është student;
- Vërtetim nga Zyra e Punësimit të Malit të Zi për persona të papunë ose vërtetim se personi është pensionist;
- Dëshmi për përvojën statistikore (kontratë pune/certifikatë/rekomandime).

---

<sup>1</sup> Vendbanimi është adresa, zona ku personi jeton

Kandidati/ja mund të aplikojë ose si instruktor/e ose si regjistruer/e.

Formularët e aplikimit për pjesëmarrës/se në regjistrim kandidati/ja mund ta marrë në ambientet e Komisionit të regjistrimit, Komuna e Ulqinit, Zyra e qytetarëve (BIRO), Bulevar Gjergj Kastrioti Skenderbeu pn., Ulqin duke filluar nga 15 nëntori dhe duke përfunduar më 22 nëntor 2023 nga ora 08:00 deri në orën 15:00; ose ta shkarkojnë atë nga faqja e internetit e Administratës të Statistikave: [www.monstat.org](http://www.monstat.org)

Aplikacioni i plotësuar për pjesëmarrësit në regjistrim dhe dokumentacioni i plotë mund të dorëzohen personalisht, në zarf të mbyllur çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në 15:00, në adresën e komisionit të regjistrimit.

Kandidatët që kanë dorëzuar dokumentacionin e plotë në Shpalljen Publike të mëparshme (i cili është shpallur në Shtator 2023) duhet të dorëzojnë vetëm Aplikacionin e plotësuar për Pjesëmarrës në Regjistrim (Formulari P-13) me rastin e kësaj Shpallje Publike. Kandidatët që nuk paraqesin Aplikacion të ri lidhur me këtë Shpallje Publike, nuk kanë dokumentacion të plotë për pjesëmarrje në regjistrim dhe nuk mund të angazhohen kontraktualisht.

Në zarf duhet të shënoni emrin e pozitës për të cilën aplikoni (instruktor ose regjistruer) dhe adresën e komisionit të regjistrimit: Komisioni i regjistrimit, Komuna e Ulqinit.

Të gjithë kandidatët duhet të nënshkruajnë një deklaratë (pjesë e dokumentacionit të aplikimit për pjesëmarrësit/et e regjistrimit) që gjatë mbajtjes së trajnimeve (22 - 24 nëntor 2023 dhe 25 - 26 nëntor 2023) dhe gjatë zbatimit të censusit të regjistrimit (30 nëntor - 15 . dhjetor 2023) të jetë në dispozicion për aktivitetet e regjistrimit.

Per informacione shtese ne numrin e telefonit: 030412050.